



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Në bazë të nenit 10 dhe 11 lidhur me nenin 14A të Ligjit Nr. 05/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

K O N K U R S

Referenca: Kodi: SKPK/POZ 012
Emri pozitës: Zyrtar për Operativ dhe Siguri
Pozita: Pozitë e karrierës
Kategoria funksionale: Profesional
Grada: 9
Raporton tek: Udhëheqësi i Divizionit për Shërbime të Përgjithshme
Kodi punës: DR/450
Numri i pozitave: Një (1) pozitë
Koeficienti: Shtatë (7)
Akti i emërimit: Pa afat
Puna Provuese: Dymbëdhjetë (12) muaj
Vendi: Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Ofron shërbime profesionale në krijimin e sistemit unik të sigurisë me qëllim të zbatimit dhe ofrimit të sigurisë për gjithë sistemin prokurorial.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Përgatit dhe propozon planin për siguri për gjithë sistemin prokurorial të Kosovës me qëllim të krijimit të sistemi të unifikuar të sigurisë në KPK dhe PSH.

Në bashkëpunim me administratoret monitoron dhe mbikëqyr punën e rojeve në vendin e punës dhe nivelin e sigurisë së objekteve.

Propozon rregulla për organizimin e punës së rojeve në sistemin prokurorial.

Përgatit raporte dhe njofton lidhur me gjendjen e sigurisë së përgjithshme ose të veçanta.

Bashkëpunon me zyrtaret e buxhetit në planifikimin e nevojave për sigurinë në sistem.

Bashkëpunon me zyrtarët përgjegjës të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit lidhur me rrezikshmërinë e lartë të tyre dhe propozon masa të sigurisë.

Përgatit udhëzime apo forma tjera në bashkëpunim me nivelet vendim marrëse për rojet dhe sigurinë në përgjithësi.

Kryen detyra tjera të parashtruara nga mbikëqyrësi.

Njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për vendin e punës:

Trajnime nga fusha përkatës.

Njohja dhe aplikimi i programeve të Microsoft Office, si dhe softuerëve dhe web aplikacioneve të ndryshme.

Aftësitë e koordinimit, bashkëpunimit dhe komunikimit me zyrtaret dhe palët.

Shkathtësi të shkëlqyera organizative dhe ekipore si dhe për të punuar me udhëheqje minimale mbikëqyrëse.

Të ketë aftësi për të punuar nën presion dhe në limite kohore.

Fleksibiliteti dhe aftësia që të punoj me vëllim pune.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë universitare, Shkenca Shoqërore

Përvoja e Punës:

2 vite përvojë pune profesionale.

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqet zyrtare të Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe në gazetata ditore, duke filluar nga data 09.11.2018 deri me datë 23.11.2018 si datë e mbylljes së konkursit.

Paraqitja e kërkesave: Formulari për aplikim mund të merret në recepsionin e ndërtesës së Prokurorit të Shtetit adresa: Rruga: "Luan Haradinaj" p.n. apo mund të printohen nga <http://www.kpk-rks.org/> apo <http://www.psh-ks.net/>.

Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë;

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038 / 200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit të kërkuar:

- 1.Dëshminë e kualifikimit shkollor;
- 2.Dëshmi mbi përvojën e punës, *Vërtetimi ose kontrata e punës.*
- 3.Dy rekomandime *(nëse keni);*
- 4.Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës *(nëse ekzistojnë të tilla);*
- 5.Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;
- 6.Çertifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.

Data e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, do të publikohen vetëm në faqet zyrtare të: Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.